# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-458615**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Përfshihet nga flakët një hotel në Britani, evakuohen rreth 300 persona, zjarri dyshohet i qëllimshëm |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/19/perfshihet-nga-flaket-nje-hotel-ne-britani-evakuohen-rreth-300-persona-zjarri-dyshohet-i-qellimisht/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 19:10:10 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 19 shtator 2026, 19:02:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 19 shtator 2026, 19:01:00 UTC → 19 shtator 2026, 19:03:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `7e9c89428d1d49d85629447c586197c34afc7b1fb98d52932ab79a971444ebc7` |
| TEKSTI | `bb714d7d24eac7c71212d5eaccc7b6fea58cd72d61a5889823a12724378c71fe` |
| PAMJA | `5d88e62e5468c71580cc3dc16f25fc6031dc9e8839e48cd1388808cf5761ce98` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `cfded504aa220bcba5b40c998571a29e920918492e63369242248d8963695ea7` |
| E MËPARSHMJA | `b0f68849b93b5a4d9b35d015f733d033e6da8298d6a636d8283416a3f336b919` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/cfded504aa220bcba5b40c998571a29e920918492e63369242248d8963695ea7`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA KRYESORE TË FUNDIT

# Përfshihet nga flakët një hotel në Britani, evakuohen rreth 300 persona, zjarri dyshohet i qëllimshëm

19/09/2026 21:02




**Një zjarr i madh ka përfshirë në orët e para të së shtunës hotelin Grand Burstin, në Marine Parade, në qytetin bregdetar të Folkestone, në Kent të Britanisë së Madhe. Shërbimet e emergjencës u njoftuan rreth orës 01:20, ndërsa në kulmin e operacionit në vendngjarje u angazhuan 26 mjete zjarrfikëse.**

Rreth 280 persona u evakuuan nga hoteli dhe u dërguan në një qendër të posaçme pritjeje të organizuar nga këshilli lokal. Autoritetet britanike konfirmuan se nuk ka raportime për persona të lënduar. Zjarri besohet se ka nisur në bodrumin e hotelit dhe u vu nën kontroll rreth orës 08:30, ndërsa disa ekipe zjarrfikëse vijuan punën gjatë ditës për shuarjen e plotë të vatrave të mbetura.

Pas hetimeve paraprake, Policia e Kentit ka deklaruar se zjarri po trajtohet si i dyshimtë dhe se ekziston dyshimi se mund të jetë shkaktuar qëllimisht.

"Hetimet për rrethanat janë duke u zhvilluar dhe oficerët tani besojnë se zjarri mund të jetë shkaktuar qëllimisht", deklaroi Policia e Kentit. Autoritetet po kërkojnë dëshmitarë, si edhe pamje nga kamerat e sigurisë dhe kamerat e automjeteve. Policia u ka bërë thirrje personave që kanë qenë në zonë nga ora 22:00 e së premtes deri në orën 00:30 të së shtunës që të dorëzojnë çdo informacion ose pamje që mund të ndihmojë hetimin.

Hoteli Grand Burstin, i operuar nga Britannia Hotels, ka rreth 550 dhoma dhe ndodhet pranë portit të Folkestone. Sipas Sky News, zjarri shkaktoi një operacion të gjerë emergjence dhe ekipet zjarrfikëse qëndruan në vendngjarje edhe disa orë pasi flakët u vunë nën kontroll.

**Top Channel**

## Bota »



Dy Gjermani në zgjedhje/ Mrekullia ekonomike e Mecklenburgut dhe kriza e strehimit në Berlin, çfarë do të përcaktojë beteja zgjedhore e të dielës

19/09 21:09



"Agjenti 007" i Putinit/ Kush është truproja misterioze Anton Afinogenov që ka tërhequr vëmendjen në Rusi

19/09 20:30



Ish-anëtarja e Pussy Riot arratiset nga Rusia: U detyrova të spiunoj për Moskën

19/09 19:37





## Kryesore



Më 8 tetor miratohet harta e re territoriale/ Votat në favor të mazhorancës, PD kundër

19:30

"Prania Besnike", zbardhet mbledhja e djeshme/ Qindra ankesa dhe dëgjesa në të gjithë vendin, Rama: Nuk është ideja thjesht që të marrim e të çojmë halle

08:26

Raporti i prodhuar gabim nga AI gati sa nuk shkaktoi luftë SHBA-Kinë, ushtria amerikane u përgatit të ndalonte anijen kineze

08:01

E papritur/ Ndahet nga jeta në moshën 22-vjeçare influencerja e njohur pak javë pas operacionit për gjoksin

10:07

Kush janë surprizat e Maranit? Një rikthim i madh, dy debutues dhe disa mungesa të bujshme

11:11

## Më të lexuarat

Bordi i Transparencës ndryshon çmimet e karburanteve, nafta dhe benzina pësojnë rënie

"Je e bukur, do të vish në hotelin tim?"/ Modelja kolumbiane publikon bisedën me futbollistin e njohur

Video/ U kap mat me gruan e një tjetri, momenti i frikshëm kur burri bie nga dritarja teksa tentoi të arratisej

Bashkëshortja e Alban Hoxhës humbi jetën pas lindjes së djalit, Gjykata e Lartë rrëzon rekursin e dy mjekëve

E papritur/ Ndahet nga jeta në moshën 22-vjeçare influencerja e njohur pak javë pas operacionit për gjoksin

SHBA dhe Danimarka arrijnë marrëveshje për Groenlandën pas kërcënimeve të Trump për aneksim

Krim i rëndë në familje në Tiranë/ 68-vjeçari vret gruan me thikë dhe arratiset nga vendngjarja, reagon policia

Foto/ Vrau gruan me thikë brenda në banesë, vetëdorëzohet autori 68-vjeçar i krimit në Tiranë. Ngjarja u pa nga nipi i mitur

Fredi Beleri "mburr" deputetin e Agimit të Artë dhe sulmon drejtësinë greke, tërheq deklaratën pas reagimeve të forta nga PASOK



Alarm në SHBA, pikaset një avion që fluturonte mbi Camp David ku po qëndronte Trump

19/09 19:04



Deti i Kuq në alarm/ Greqia dhe Italia kërkojnë më shumë anije luftarake përballë Huthëve

19/09 18:01



Vrasjet e nëntë grave tronditin Afrikën e Jugut, protesta dhe marshime kundër dhunës

19/09 17:45

Alarm në Zvicër për Granit Xhakën, prokuroria hap hetim për certifikatat e COVID-it

## Kryesore »



Mbi 414 kilogramë drogë e sekuestruar, arrestohet 29-vjeçari shqiptar në Itali, si i 'ikën nga duart' 4 milionë euro

19/09 21:21



Klasifikimi i Abissnet Superiore/ Si është pozicioni i skuadrave pas 3 ndeshjeve të para të javës së pestë

19/09 21:20



Dy Gjermani në zgjedhje/ Mrekullia ekonomike e Mecklenburgut dhe kriza e strehimit në Berlin, çfarë do të përcaktojë beteja zgjedhore e të dielës

19/09 21:09



Analiza/ Pas Hagës, kush do ta çojë përpara drejtësinë për krimet e luftës në Ballkan?

19/09 21:05



Dinamo mban hapin e Teutës, mposht Laçin dhe iu afrohet durrsakëve në renditje

19/09 20:30



Roma dhe Inter dhurojnë spektakël në Olimpico, kryesueset e Serie A e mbyllin supersfidën në barazim

19/09 20:04

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top News – Dronët fluturojnë mbi Moldavi. Autoritetet në alarm, cënohet siguria kombëtare



Top News – Beleri 'kryqëzohet' në Greqi. Shkak, deklarata për ish-deputetin e Agimit të Artë



Top News- Mbrojtje ajrore për Ukrainën/ SHBA jep 'dritën jeshile', Zelensky fërkon duart i lumtur



Top News – 10 mijë euro për të jetuar në Çamëri. Greqia plan për ripopullimin të zonave kufitare



Top News – Shqipëria e 44-ta në nivel global në Indeksin e SDG-ve, Rama: Ecim përpara



Top Channel/ Fredi Beleri ndez debat në Greqi, kërkon ndjesë: Formulimi për Kasidiarisin, i pavend




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.